



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 129

Tiranë – E enjte, 14 korrik 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 29.6.2016	Për shpërndarjen e pjeshme të të ardhurave nga privatizimi i shoqërisë “INSIG” sh.a..... 10415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 6.7.2016	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për akordimin e grantit ekonomiko-teknik..... 10415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 6.7.2016	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Urdhrit Sovran Ushtarak Spitalor të Shën Gjorit të Jerusalemit të Rhodes dhe Maltës..... 10416
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 6.7.2016	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Izraelit, për bashkëpunim në fushat e shëndetit e mjekësisë..... 10418
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 6.7.2016	Për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Mynih, në Republikën Federale të Gjermanisë..... 10419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 6.7.2016	Për përdorimin dhe kontrollin e fondit operativ të Policisë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 10420
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 6.7.2016	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve..... 10420
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 6.7.2016	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaktit dhe nivelet e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore..... 10422

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 6.7.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 796, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjesisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 98, me emërtim “Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, për dhënien në përdorim të përkohshëm të disa objekteve e të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar” .....	10427
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 6.7.2016	Për miratimin e marrëveshjes së rinovuar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit dhe për një shtesë Fondi Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.....	10429

**VENDIM****Nr. 498, datë 29.6.2016**

**PËR SHPËRNDARJEN E PJESSHME TË  
TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I  
SHOQËRISË “INSIG” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 9, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kufiri i shpenzimeve kapitale dhe niveli i deficitit buxhetor, miratuar në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, shtohet me 1 100 000 000 (një miliard e njëqind milionë) lekë nga të ardhurat e realizuara nga privatizimi i shoqërisë “INSIG” sh.a.

2. Fondi prej 1 100 000 000 (një miliard e njëqind milionë) lekësh i shtohet kufirit të shpenzimeve kapitale të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në programin “Transporti rrugor”, për projektin “Ndërtim rruge: Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës) loti 1”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**

**VENDIM****Nr. 499, datë 6.7.2016**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,  
PËR AKORDIMIN E GRANTIT  
EKONOMIKO-TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për akordimin e grantit ekonomik-teknik, sipas tekstit bashkë-lidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**

**MARRËVESHJE**

**PËR AKORDIMIN E GRANTIT  
EKONOMIKO-TEKNIK, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE  
TË KINËS**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Popullore e Kinës, për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e miqësisë dhe të bashkëpunimit ekonomik-teknik ndërmjet dy vendeve, bien dakord si më poshtë:

**Neni 1**

Sipas nevojave të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeveria e Republikës Popullore e Kinës i jep Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë një grant me vlerë 10 milionë juan RMB që do të përdoren për realizimin e pajisjeve bujqësore në ndihmë të Shqipërisë, si dhe në objekte që do të përcaktohen bashkërisht nga qeveritë e të dyja vendeve. Çështjet specifike do të caktohen në marrëveshje të tjera që do të lidhen ndërmjet palëve.

**Neni 2**

1. Korporata e Bankës së Zhvillimit të Kinës dhe Banka e Shqipërisë do të hapin respektivisht nga një llogari bankare në emër të njëra-tjetrës, e cila nuk do të ketë interes apo komision që do të jetë në monedhën kineze juan RMB, e referuar shkurtimisht si “Llogaria e ndihmës nr. 2015/1”

2. Gjatë periudhës së përdorimit të shumës së akorduar të grantit, të dyja palët duhet të bëjnë një raportim financiar në përputhje me rregullat përkatëse të Korporatës së Bankës së Zhvillimit të Kinës dhe do të informojnë periodikisht qeveritë e të dyja vendeve mbi përdorimin e llogarive.



## Neni 3

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën kur palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj dhe do të jetë e vlefshme derisa të dyja qeveritë të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Tiranë, në datën 6 qershor 2016, në dy kopje origjinale, ku secilës palë 1 jepet një kopje. Çdo kopje nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe kineze, ku secili tekst ka fuqi ligjore të njëjtë.

**VENDIM**

Nr. 500, datë 6.7.2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË  
BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
URDHRIT SOVRAN USHTARAK  
SPITALOR TË SHËN GJONIT TË  
JERUSALEMIT TË RHODES DHE  
MALTËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Urdhrit Sovran Ushtarak Spitalor të Shën Gjonit të Jerusalemit të Rhodes dhe Maltës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE URDHRIT SOVRAN USHTARAK  
SPITALOR TË SHËN GJONIT TË  
JERUSALEMIT TË RHODES DHE MALTËS**

Republika e Shqipërisë dhe Urdhri Sovran Ushtarak Spitalor i Shën Gjonit të Jerusalemit të Rhodes dhe Maltës (Urdhri Sovran i Maltës),

të referuara më poshtë si “Palët Kontraktuese”,  
*duke marrë në konsideratë marrëdhëniet tradicio-  
nalisht të shkëlqyera që prej vendosjes së marrë-  
dhënieve diplomatike ndërmjet Palëve Kontrak-  
tuese në vitin 1994;*

*duke dëshiruar të forcojnë më tej lidhjet miqësore  
që ekzistojnë midis tyre nëpërmjet nxitjes së  
bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet Palëve  
Kontraktuese;*

*duke marrë në konsideratë traditën e gjatë të  
bashkëpunimit në fushën e ndihmës mjekësore,  
humanitare dhe shëndetësore ndërmjet Palëve  
Kontraktuese;*

*duke marrë në konsideratë se Urdhri Sovran i  
Maltës i është përkushtuar shërbimit ndaj të  
sëmurëve dhe të varfërve në botë që prej  
themelimit të tij 900 vjet më parë;*

*duke marrë në konsideratë dëshirën për të  
lehtësuar ndihmën humanitare të Urdhrit Sovran të  
Maltës në territorin e Republikës së Shqipërisë,  
bien dakord:*

## Neni 1

**Qëllimi i Marrëveshjes**

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që të caktojë kuadrin e përgjithshëm dhe udhëzimet e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Urdhrit Sovran të Maltës, të synuar për nxitjen e masave të kujdesit shëndetësor dhe spitalor të kësaj të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.2 Mbështetur në mjetet që kanë në dispozicion, Palët Kontraktuese do të mbështesin dhe zbatojnë masat e synuara për lehtësimin, zhvillimin dhe diversifikimin e bashkëpunimit të tyre social, humanitar dhe shëndetësor, si dhe asistencën për trajnimin e burimeve njerëzore.

1.3 Në rast emergjencash, nevoje ose ngjarjeje të papritur dhe në mungesë të marrëveshjeve specifike të përcaktuara më lart, kjo marrëveshje do të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për veprimtaritë që do të ndërmerren me iniciativë dhe nën mbikëqyrjen e Palëve të Larta Kontraktuese.

## Neni 2

**Zbatimi i projekteve me organizatat e varësisë dhe partnerët e Urdhrit Sovran të Maltës**

2.1. Me qëllim përmbushjen e misionëve të tij, Urdhri Sovran i Maltës merr masa në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet organizatave të tij të



varësisë. Në këtë Marrëveshje, organizatat e varësisë synohen si komponentë kryesorë, shërbime ndihme, shoqata kombëtare ose institucione të tjera të lidhura me Urdhrin Sovran të Maltës dhe të themeluara me synim realizimin e punimeve të tyre, të tilla si “Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës” të Urdhrit Sovran të Maltës ose Malteser International, agjencia e saj mbarëbotërore e ndihmës. Këto organizata varësie veprojnë brenda kuadrit të kompetencave të tyre; si rrjedhojë ato mund të lidhin marrëveshje specifike që lidhen me to.

Neni 3·

### Objektivi i bashkëpunimit

3.1 Palët Kontraktuese do të bëjnë përpjekje për të nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë, sipas ligjeve, rregullave dhe rregulloreve ndërkombëtare, në harmoni me politikën e tyre përkatëse mbi bazën e parimeve të barazisë dhe respektimit të ndërsjellë të sovranitetit.

Neni 4

Bashkëpunimi i parashikuar në këtë Marrëveshje do të jetë në fushat e mëposhtme:

- a) Shëndetësi;
- b) Siguri e ushqimit;
- c) Shkëmbim kulturash;
- d) Arsim dhe formim profesional;
- e) Vullnetarizëm lokal dhe ndërkombëtar;
- f) Ulje e rrezikut nga katastrofat, lista nuk është gjithëpërfshirëse.

Neni 5

### Komiteti i vlerësimit

5.1 Me qëllimin për të siguruar vazhdimin e duhur të bashkëpunimit, krijohet një Komitet Vlerësimi për të shqyrtuar dhe zgjedhur projekte dhe plane bashkëpunimi, për të ruajtur objektivat e përcaktuar në këtë marrëveshje. Në këtë drejtim, Komiteti përgatit raporte vjetore të rezultateve të marra nga projektet e realizuara dhe përcakton projekte dhe programe për t'u zbatuar në të ardhmen.

5.2 Komiteti i Vlerësimit përbëhet nga dy përfaqësues të secilës Palë. Anëtarët e saj përzgjidhen në marrëveshje me Këshillin e Ministrave të përfaqësuar nga Departamenti i Programit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuar nga Drejtoria

e Integritimit Evropian dhe IPA, si dhe Ambasadori i Urdhrit Sovran të Maltës për Republikën e Shqipërisë. Komiteti takohet të paktën një herë në vit me ftesë të secilës Palë.

Neni 6

### Mbrojtja e identitetit

6.1 Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Palët Kontraktuese angazhohen të mbrojnë në mënyrë të ndërsjellë emrat, emblemat, stemat, flamujt dhe simbolet e tjera të sovranitetit ndaj abuzimit apo dhunimit dhe garantojnë t'i mbrojnë ato ndaj çdo imitimi.

Neni 7

### Hyrja në fuqi Kohëzgjatja dhe rinovimi

7.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 10-vjeçare, e cila rinovohet automatikisht me miratim në heshtje dhe do të hyjë në fuqi pasi Palët Kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme të legjislacioneve të tyre.

7.2 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje çdonjëra nga Palët Kontraktuese mund të propozojë me shkrim ndryshime për të cilat Pala tjetër duhet të përgjigjet me shkrim dhe nëse ndryshimi miratohet me marrëveshje reciproke dhe sipas legjislacionit të secilës prej Palëve Kontraktuese ky ndryshim do të konsiderohet i shkruar në këtë Marrëveshje.

7.3 Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga çdonjëra prej Palëve Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike me një njoftim me shkrim njëra-tjetrës, të paktën 6 (gjashtë) muaj para.

Neni 8

### Gjuha dhe depozitimi

8.1 Kjo Marrëveshje do të shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze, të katër origjinale autentike dhe të vlefshme.

8.2 Palët e larta kontraktuese bien dakord mbi përdorimin e barabartë dhe të padalluar të gjuhës angleze dhe shqipe, si gjuha e shprehjes dhe e shkrimit të çdo korrespondence lidhur, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, me njohjen e kësaj Marrëveshjeje.

8.3 Secila prej Palëve konsiderohet si depozituese e origjinalit të kësaj Marrëveshjeje.



Bërë në Tiranë, më 15 qershor 2016.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**Ometa Barbullushi**

Zëvendësministër i Punëve të Jashtme

PËR URDHRIN SOVRAN USHTARAK  
SPITALOR TË SHËN GJONIT TË JERU-  
SALEMIT TË RHODES DHE MALTËS

**Stefano Palumbo**

Ambasador në Republikën e Shqipërisë

### VENDIM

Nr. 501, datë 6.7.2016

### PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHAT E SHËNDETIT E MJEKËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Izraelit, për bashkëpunim në fushat e shëndetit e mjekësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

### MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT PËR  
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E  
SHËNDETIT DHE MJEKËSISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shtetit të Izraelit (në vijim të referuara si “Palët”);

*duke marrë parasysh* përfitimet e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shëndetësisë dhe mjekësisë;

*të udhëhequr nga* dëshira për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie dypalëshe në fushën e shëndetit dhe mjekësisë për të përmirësuar nivelin e kujdesit shëndetësor për popullsinë e tyre, kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetit dhe mjekësisë mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit të ndërsjellë.

#### Neni 2

Palët do të përpiqen të nxisin:

- shkëmbimin e informacionit dhe të dokumentacionit mbi tema që lidhen me shëndetësinë në fusha me interes të përbashkët;

- shkëmbimin e vizitave të specialistëve, me qëllim përmirësimin e kualifikimit dhe konsultimeve;

- shkëmbimin e informacionit mbi pajisjet mjekësore, aparaturat mjekësore, produktet farmaceutike dhe zhvillimet teknologjike që lidhen me mjekësinë dhe shëndetin publik;

- shkëmbimin e informacionit mbi konferenca ndërkombëtare, takime dhe evente të tjera që do të zhvillohen në secilin vend;

- forma të tjera bashkëpunimi në fushën e mjekësisë dhe shëndetit publik, siç mund të jenë rënë reciprokisht dakord.

#### Neni 3

Palët do të organizojnë shkëmbimin e vizitave mjekësore të specialistëve për periudha kohore të rëna dakord reciprokisht, me qëllim studimin e teknikave moderne diagnostikuese dhe terapeutike.

Demonstrime klinike do të kryhen në përputhje me rregulloret e praktikave mjekësore të vendit mikpritës.

#### Neni 4

Palët do të inkurajojnë zhvillimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet institucioneve shëndetësore dhe atyre mjekësore. Kontaktet ndërmjet këtyre institucioneve do të realizohen në përputhje me ligjin e vendeve të tyre përkatëse dhe në bazë të marrëveshjeve të drejtpërdrejta.



## Neni 5

Palët, në kuadrin e pjesëmarrjes së secilës prej tyre në punën e organizatave të specializuara ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë [dhe mjekësisë], do të bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit.

## Neni 6

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ia beson Ministrisë së Shëndetësisë dhe qeveria e Shtetit të Izraelit ia beson Ministrisë së Shëndetësisë të Shtetit të Izraelit zbatimin e kësaj marrëveshjeje në vendet e tyre përkatëse.

Për të zbatuar këtë Marrëveshje, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Shëndetësisë e Shtetit të Izraelit do të nënshkruajnë Planin e Bashkëpunimit.

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet disponueshmërisë së fondeve.

Zbatimi i Marrëveshjes nga secila palë dhe aktivitetet që secila Palë ndërmerr, i nënshtrohen zbatimit të ligjit të brendshëm të secilës palë.

## Neni 7

Çdo çështje apo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta ndërmjet palëve.

## Neni 8

I gjithë informacioni i përcjellë nga palët, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet rreptësisht konfidencial dhe nuk do t'u përcillet palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të palës nga e cila e ka origjinën. Për shmangien e dyshimit, kjo Marrëveshje nuk zbatohet për të dhëna personale.

Në rast se parashikohet zbulimi i të dhënave personale, ky zbulim i të dhënave kushtëzohet dhe i nënshtrohet një marrëveshjeje të veçantë me shkrim që do të lidhet ndërmjet palëve.

## Neni 9

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin dhe miratimin e ndërsjellë me shkrim të palëve.

## Neni 10

Kjo Marrëveshje, si dhe çdo ndryshim i saj do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të fundit me

shkrim nëpërmjet të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën se kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes apo ndryshimeve, sipas rastit, kanë përfunduar.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 5 vitesh dhe do të rinovohet në mënyrë automatike për periudhat pasuese prej 5 (pesë) vitesh. Secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen në çdo kohë, duke i dhënë njoftim paraprak me shkrim palës tjetër të paktën 6 (gjashtë) muaj para, në lidhje me përfundimin e saj.

Bërë në Jerusalem, më 21 dhjetor 2015, e cila korrespondon me , 5776 në kalendarin hebraik, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, hebraisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëllor autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**VENDIM**

**Nr. 502, datë 6.7.2016**

**PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË  
PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË NË MYNIH, NË  
REPUBLIKËN FEDERALE TË  
GJERMANISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Mynih, në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**



## VENDIM

Nr. 503, datë 6.7.2016

**PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN  
E FONDIT OPERATIV TË POLICISË  
USHTARAKE NË FORCAT E  
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Policia Ushtarake përdor fondin operativ, që i vihet në dispozicion për realizimin e veprimtarive specifike, brenda fondeve të miratuara në buxhetin vjetor për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Fondi operativ i Policisë Ushtarake përdoret për:

a) shpenzime për sigurimin e informacionit dhe mbështetjen e veprimtarisë operative;

b) shpenzime për marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve në funksion të veprimtarive operative;

c) shpenzime për veprimtarinë procedurale penale për oficerin dhe agjentin e Policisë Gjyqësore ose personin e autorizuar prej tyre, gjatë kryerjes së operacioneve, ku përdoren metoda të posaçme hetimi (përgjime, veprime simuluese dhe infiltrime).

3. Vlera e fondit operativ është deri në 2% të vlerës së buxhetit vjetor të Policisë Ushtarake.

4. Kontrolli mbi përdorimin e fondit operativ ushtrohet, jo më pak se një herë në vit, nga ministri i Mbrojtjes ose personat e autorizuar prej tij, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie. Kontrolli ushtrohet duke respektuar legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

5. Ministri i Mbrojtjes nxjerr udhëzim për përcaktimin e procedurave e të dokumentacionit të nevojshëm për përdorimin e këtij fondi.

6. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

## VENDIM

Nr. 504, datë 6.7.2016

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË  
KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-  
KANALIZIMEVE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK).

2. AKUK-u është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

3. AKUK-u është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Ajo mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale, si dhe politikat përkatëse për administrimin e ujërave dhe mbrojtjen mjedisore të cilësisë së ujërave.

4. AKUK-u ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga ministri i Transportit dhe Infrastrukturës. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.

## II. ORGANIZIMI I AKUK-ut

1. AKUK-u ka statusin e agjencisë kombëtare në nivel qendror, me seli në Tiranë.

<sup>1</sup> Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 23 tetor 2000, “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, nr. CELEX: 32000L0060, (Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, L. 327, 22.12.2000, p. 1–73)





2. AKUK-u ka në përbërjen e saj edhe tri drejtori rajonale, si pjesë të strukturës brenda organikës së saj.

3. AKUK-u drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

4. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm të AKUK-ut dhe nëpunësve të saj rregullohen sipas legjislacionit për shërbimin civil. Për punonjësit që zbatojnë projektet e huaja respektohen aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Struktura dhe organika e AKUK-ut miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

6. Metodatat e brendshme të punës dhe sjellja e personelit të AKUK-ut miratohen nga ministri përgjegjës për infrastrukturën.

### III. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E AKUK-ut

1. AKUK-u, nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror dhe vendor.

2. AKUK-u ushtron këto kompetenca:

a) Mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

b) Mund t'i propozojë ministrisë së linjës ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve e trajtimit të ujërave të ndotura dhe është pjesë e grupeve të punës për hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare për sektorin;

c) I propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin e sistemeve të ujësjellësve, rrjeteve të kanalizimeve, impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanin kombëtar sektorial;

ç) Kontrollon dhe miraton, nga pikëpamja teknike, të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve

dhe ITUN-eve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë UK apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, ndjek zbatimin e projekteve me financim të huaj, në këtë fushë, si dhe të kontratave të lidhura, duke qenë përgjegjëse edhe për monitorimin e ecurisë së tyre;

d) Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

dh) Është përgjegjëse për metodologjinë dhe shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;

e) Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave dhe programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

ë) Ka të drejtë të ushtrojë kontrole, me karakter teknik, në çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve të furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe dorëzon të dhënat për përdorimin e ujit në Kadastrën Kombëtare të Ujit, pranë ministrisë përgjegjëse;

f) Ka të drejtën e përcaktimit të treguesve dhe kritereve që duhet të arrijë çdo ofrues i shërbimeve në këtë sektor në kontratën e performancës, e cila firmoset nga palët. Këto kritere miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për infrastrukturën;

g) Mbështet politikëbërësit për hartimin e zbatimit e akteve nënligjore dhe procedurave, për procesin e kalimit të administrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, nga pushteti vendor në atë qendror, në rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale;

gj) Planifikon nevojat për trajnime dhe koordinon punën për realizimin e trajnimeve e certifikimit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

h) Ngre një sistem informacioni, nëpërmjet krijimit të një regjistri elektronik dhe shkresor publik, i cili përmban informacionin lidhur me:

i) planifikimin e investimeve që bën secila shoqëri;



ii) projektakte dhe akte për miratimin e projekteve;

iii) kërkesa për finacime etj.;

i) Koordinon nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë dhe ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. Përgatit, gjithashtu, projekte zhvillimore dhe projekte pilot, me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera qendrore.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, transformohet në Agjenci Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe funksionet e DPUK-së do të vazhdojnë të ushtrohen prej saj, deri në fillimin e veprimtarisë së organeve të Agjencisë. Për nëpunësit civilë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, zbatohen dispozitat e përcaktuara në legjislacionin e nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucioneve.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

3. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**

#### VENDIM

**Nr. 505, datë 6.7.2016**

### **PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË QENDRËS KOMBËTARE TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT DHE NIVELET E SHËRBIMIT TË TRANSFUZIONIT NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 1 e 15, pika 1, të ligjit nr. 9739, datë 21.5.2007, “Për shërbimin e transfuzionit të

gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Nivelet e shërbimit të strukturave të transfuzionit të gjakut kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) Niveli I: Komiteti Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut (KKGJ);

b) Niveli II: Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut.

2. Komiteti Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut është organ këshillimor, i cili funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga ministri i Shëndetësisë.

3. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut përbëhet nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe strukturat e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore publike të shërbimit spitalor.

4. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, e specializuar për kryerjen e shërbimeve të transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut kryen këto shërbime:

a) Shërbime prodhuese, në të cilat përfshihen promovimi i dhurimit vullnetar falas të gjakut, seleksionimi dhe kontrolli periodik i dhuruesit të gjakut, mbledhja e gjakut, përpunimi dhe testimi i tij, ruajtja, transporti i gjakut/produkteve të tij, kontrolli i cilësisë të gjakut, si dhe i produkteve të tij;

b) Shërbime ndaj spitalit, në të cilat përfshihen shpërndarja e gjakut dhe e produkteve të tij pacientëve në nevojë dhe testet imunohematologjike.

5. Strukturat e shërbimit të transfuzionit në institucionet shëndetësore publike të shërbimit spitalor janë, si më poshtë vijon:

a) Bankat rajonale të gjakut në të cilat kryhen:

i) shërbime prodhuese, ku përfshihen promovimi i dhurimit vullnetar falas të gjakut, seleksionimi dhe kontrolli periodik i dhuruesit të gjakut, mbledhja e gjakut, përpunimi, ruajtja, transporti i gjakut/produkteve të tij;

ii) shërbime ndaj spitalit, ku përfshihen shpërndarja e gjakut dhe produkteve të tij pacientëve në nevojë dhe testet imunohematologjike.



b) Bankat mbledhëse dhe shpërndarëse të gjakut në të cilat kryhen:

i) shërbime prodhuese, ku përfshihen promovimi i dhurimit vullnetar falas të gjakut, seleksionimi dhe kontrolli periodik i dhuruesit të gjakut, mbledhja e gjakut, ruajtja, transporti i gjakut/produkteve të tij;

ii) shërbime ndaj spitalit, ku përfshihen shpërndarja e gjakut dhe produkteve të tij pacienteve në nevojë dhe testet imunohematologjike.

c) Bankat shpërndarëse të gjakut, në të cilat kryhen vetëm shërbime ndaj spitalit, ku përfshihen shpërndarja e gjakut dhe e produkteve të tij pacientëve në nevojë dhe testimet imunohematologjike.

6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut ofron produktet e mëposhtme:

a) Produktet eritrocitare:

i) Gjak i plotë;

ii) Qeliza të kuqe;

iii) Qeliza të kuqe në SAGM (salinë, adeninë, glukozë, manitol);

iv) Qeliza të kuqe pa *buffy-coat* pa solucion shtesë;

v) Qeliza të kuqe pa *buffy-coat* me solucion shtesë;

vi) Qeliza të kuqe të leukodepletuar;

vii) Qeliza të kuqe të shpëllara.

b) Produktet plazmatike:

i) Plazmë e freskët e ngrirë;

ii) Plazmë e varfër në krioprecipitat;

iii) Krioprecipitat.

c) Produktet trombocitare:

i) Trombocite të prodhuara nga plazma e pasur në trombocite;

ii) Trombocite të prodhuara nga *buffy-coat*.

7. Produktet e gjakut të prodhuara nga Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut duhet të plotësojnë standardet e paraqitura në aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut kryen detyrat e ngarkuara nga ligji, si dhe kryen funksionet e bashkërendimit të punës e të kontrollit tekniko-administrativ, në bashkëpunim me Komitetin Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut.

9. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ka edhe këto përgjegjësi:

a) Siguron mbështetje për zbatimin e programin kombëtar të veprimeve të shërbimit të transfuzionit;

b) Në bashkëpunim me Komitetin Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut është përgjegjëse për hartimin dhe shpërndarjen e akteve nënligjore e të udhëzuesve përkatës për Shërbimin Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë;

c) Përllogarit koston e shërbimeve e të produkteve të ofruara nga Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut;

ç) Siguron zbatimin sistematik të programit për kontrollin e cilësisë e atë mikrobiologjik të procedurave të mbledhjes e të përpunimit të gjakut, kontrollin dhe vlerësimin e metodave diagnostike e të procedurave të zbatuara në shërbimin e transfuzionit;

d) Raporton për aktivitetin e saj në Drejtorinë e Administrimit Spitalor, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë periodike dhe vjetore brenda 10-ditëshit të parë të muajit pasardhës, sipas rregullores përkatëse, të miratuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.

10. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut rregullohen nga dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

11. Mënyra dhe procedurat për punësimin, lëvizjet dhe transferimin e stafit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut miratohen nga ministri i Shëndetësisë.

12. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut drejtohet nga drejtori, i cili emërohet dhe lirohet nga ministri i Shëndetësisë.

13. Drejtori i Qendrës Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ka këto përgjegjësi kryesore:

a) Drejton dhe bashkërendon detyrat e punonjësve me qëllim përmbushjen me sukses të rolit të Qendrës;

b) Përgatit programin e vetëmjaftueshmërisë kombëtare dhe e paraqet atë për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Administrimit Spitalor, në fillim të çdo viti kalendarik, mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 9739, datë 21.5.2007, “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Drejton punën për hartimin e projekt-buxhetit ekonomik dhe financiar, miraton buxhetin e zbërthyer për çdo shërbim dhe raport,



miraton programin e buxhetit në të gjithë zërat e tij;

ç) Administron fondet buxhetore dhe fondet e tjera të krijuara sipas legjislacionit në fuqi për funksionimin normal të Qendrës;

d) Bashkëpunon ngushtë me institucionet e ndryshme dhe organizatat që operojnë në fushën e transfuzionit të gjakut brenda dhe jashtë vendit;

dh) Përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me të tretët;

e) I propozon Komitetit Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut, për miratim nga ministri i Shëndetësisë, të rregullores së brendshme të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut;

ë) Siguron që çdo njësi gjak apo komponent është mbledhur, testuar, përpunuar, ruajtur dhe shpërndarë sipas të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;

f) Siguron informacionin e duhur për ngritjen, akreditimin ose licencimin e çdo strukture transfuzionale;

g) I propozon ministrit të Shëndetësisë emërimin dhe lirimin nga detyra të zëvendës-

drejtorit teknik e ekonomik;

gj) Siguron bazën pedagogjike për specializimin e mjekëve në specialitetin “Mjekësi transfuzive” dhe bashkëpunimin me Fakultetin e Mjekësisë për trajnimin e vazhdueshëm të specialistëve që punojnë në strukturat e shërbimit të transfuzionit në vend.

14. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut kryen shërbime të transfuzionit sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit të Financave.

15. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat për shërbimin e transfuzionit derdhen në buxhetin e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe përdoren me miratim të ministrit të Shëndetësisë.

16. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**

#### ANEKSI I

#### STANDARDET E GJAKUT DHE PRODUKTEVE TË TIJ

Emri i produktit	Parametrat e kontrolluar	Rezultati i duhur
Gjaku i plotë	Grupi ABO, Rh D	Përcaktimi i grupit të gjakut në të gjitha njësitë
	Anti-HIV1/2, anti-HCV, HBsAg, Sifiliz , CMV	Negativ me testet e miratuara për të gjitha njësitë
	Volumi	450 ± 10 ml
	Hemoglobina	Jo më pak se 45 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës eritrocitare
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Qeliza të kuqe <sup>1</sup>	Volumi	Të vlefshme për të ruajtur vlerat e Hb dhe hemolizës brenda standardeve (280 ± 50ml)
	Hct	0.65-0.75
	Hemoglobina	minimumi 45 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës së qelizave të kuqe
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Qeliza të kuqe pa <i>buffy-coat</i> pa solucion shtesë	Volumi	Të vlefshme për të ruajtur vlerat e Hb dhe hemolizës brenda standardeve (250 ± 50).
	Hct	0.65–0.75
	Hemoglobina	minimumi 43 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës së qelizave të kuqe



	Nr. i leukoçiteve/njësi*	< $1.2 \times 10^9$ / njësi
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Qeliza të kuqe në solucion shtesë, SAGM	Volumi	Të vlefshme për të ruajtur vlerat e Hb dhe hemolizës brenda standardeve.
	Hemoglobina	Jo më pak se 45 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës eritrocitare
	Hct	0.50–0.70
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Qeliza të kuqe pa <i>buffy-coat</i> <sup>2</sup> me solucion shtesë	Volumi	Të vlefshme për të ruajtur vlerat e Hb dhe hemolizës brenda standardeve.
	Hct	0.50–0.70
	Hemoglobina	minimumi 43 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës eritrocitare
	Nr. i leukoçiteve/njësi*	< $1.2 \times 10^9$ /për njësi
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Qeliza të kuqe të leukodepletuara	Volumi	Të vlefshme për të ruajtur vlerat e Hb dhe hemolizës brenda standardeve.
	Hemoglobina	Minimumi 40 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës eritrocitare
	Hct	0.50–0.70
	Nr. i leukoçiteve/njësi*	< $1 \times 10^6$ / për njësi
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Qeliza të kuqe të shpëlarë	Volumi	Të vlefshme për të ruajtur vlerat e Hb dhe hemolizës brenda standardeve
	Hemoglobina	Minimumi 40 g/njësi
	Hemoliza në fund të ruajtjes	< 0.8% të masës eritrocitare
	Hct	0.65–0.75
	Proteina totale/njësi	< 0.5 g/njësi
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Masë tromboçitare, (njësi e vetme)	Volumi	I përshatshëm me kushtet e ruajtjes së produktit me qëllim sigurimin e ph të tij brenda standardeve të përcaktuara.
	Nr. i tromboçiteve/njësi**	> $60 \times 10^9$ / për njësi
	Nr. i leukoçiteve residuale për/njësi*	
	a) përgatitur nga plazma e pasur me tromboçite	< $0.2 \times 10^9$ / për njësi
	b) përgatitur nga <i>buffy-coat</i>	< $0.05 \times 10^9$ / për njësi
	Ph në fund të kohës së ruajtjes	6.4–7.4



	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuar në rregulloren përkatëse
Masë tromboçitare nga pooli <i>buffy-coat</i>	Volumi >40ml/60x10 <sup>9</sup> tromboçite	I përshtatshëm me kushtet e ruajtjes së produktit me qëllim sigurimin e pH të tij brenda standardeve të përcaktuara
	Nr. i tromboçiteve/njësi**	> 2 x 10 <sup>11</sup> /për njësi
	Nr. i leukoçiteve residuale për /njësi*: a) të pafiltruara; b) të filtruara	< 1 x 10 <sup>9</sup> < 1 x 10 <sup>6</sup>
	Ph në fund të kohës së ruajtjes	6.4–7.4
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Plazmë e freskët e ngrirë	Volumi	Volumi i vendosur ±10%
	Faktori VIII*** pas ngrirjes dhe shkrirjes	Jo më pak se > 70UI Faktor VIII/100ml
	Nr. i eritroçiteve	< 6 x 10 <sup>9</sup> /litër
	Nr. i leukoçiteve	<0.1x 10 <sup>9</sup> /litër
	Nr. i tromboçiteve	<50x 10 <sup>9</sup> /litër
	Proteina totale	Jo më pak se 50g/litër
	Kontroll vizual	Mungesë të klots dhe ngjyrës jonormale
	Rrjedhja	Mungesë rrjedhjeje nga qesja e plazmës Kontrolli vizual i njësisë pas përpunimit dhe përpara procedurës së ngrirjes
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Plazmë e varfër në krio	Grupi ABO, Rh D
Anti-HIV1/2, anti-HCV, HBsAg, Sifiliz, CMV		Negativ për të gjitha njësitë me teste të miratuara
Volumi		Volumi i vendosur ±10%
Etiketimi		Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Testi i kontaminimit bakterial		Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
Krioprecipitat	Volumi	30–40 ml të gjitha njësitë
	Faktori VIII c****	≥70 IU/njësi
	Fibrinogjen	≥ 140mg/njësi
	Faktori Von Willebrand****	>100 IU/njësi
	Etiketimi	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse
	Testi i kontaminimit bakterial	Sipas standardeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse

1. Qeliza të kuqe nënkupton qelizat e kuqe që përftohen nga një dhurim i vetëm gjaku të plotë pas largimit të pjesës më të madhe të plazmës.

2. *Byffy-coat* nënkupton një shtresë qelizash që përftohen pas centrifugimit të gjakut të plotë dhe gjendet midis plazmës dhe eritroçiteve. Kjo shtresë qelizash përmban një numër të konsiderueshëm leukoçitesh dhe tromboçitesh.

\* Produkti është i përshtatshëm për përdorim nëse 90% e mostrave të kontrolluara i plotësojnë standarde e kërkuara.

\*\* Produkti është i përshtatshëm për përdorim nëse 75% e mostrave të kontrolluara i plotësojnë standardet e kërkuara.



\*\*\* Produkti në stokun e bankës së gjakut do të kontrollohet çdo 3 muaj. 10 njësi do të kontrollohen në muajin e parë të kohës së ruajtjes. Numri i leukoцитеve do të përcaktohet përpara ngrirjes së produktit.

\*\*\*\* produkti në stokun e bankës së gjakut do të kontrollohet çdo 2 muaj. Kontrolli do të kryhet gjatë muajit të parë dhe të fundit të ruajtjes.

### VENDIM

Nr. 506, datë 6.7.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 796, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TË MINISTERIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS NR. 98, ME EMËRTIM “GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË DISA OBJEKTEVE E TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM “INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MYSLYM KETA”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 796, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... dhe dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 30-vjeçare, të disa objekteve, si dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5 931,2 (pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një presje dy) m<sup>2</sup>, brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për vendosjen e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për plotësimin e nevojave institucionale të këtij institucioni ...”, shfuqizohen.


2. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**



PLAN VENDOSJA E REP. USHT. 7030, Prona nr.6  
 pjesa që do t'i jepet në përdorim Ministrisë së Drejtësisë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve



PUNOI  
 TOP. NIKOLL TUSHI

SHKALLA 1 : 1000

DREJTORI I IGJIU  
 N/KOLONEL ZYDI ALCANI



**VENDIM**

Nr. 507, datë 6.7.2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË  
RINOVUAR, NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË  
“MICROSOFT CORPORATION”, PËR  
PROJEKTIN E PARTNERITETIT  
STRATEGJIK NË FUSHËN E  
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DHE PËR NJË SHITESË FONDI  
AGJENCISË KOMBËTARE TË  
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17 e 27, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, si dhe të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e marrëveshjes së rinovuar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi total prej 1 976 400 000 (një miliard e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind mijë) lekësh për realizimin e projektit të partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit të përballohet nga buxheti i shtetit.

3. Fondi prej 295 354 773,79 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, i parashikuar për realizimin e projektit të partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Ky fond i alokohet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

4. Autorizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të lidhur marrëveshjet e parashikuara për zbatimin e projektit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit, sipas përcaktimeve në marrëveshjen bazë të partneritetit, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**

**MARRËVESHJE E PARTNERITETIT  
STRATEGJIK**

(Rinovim)

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit Strategjik (në vijim e referuar si “MPS”) lidhet më 29.6.2016 në Tiranë, Shqipëri (në vijim referuar si “data e hyrjes në fuqi”), nga dhe ndërmjet:

“Microsoft Albania”, rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga z. Sokol Vladi, drejtor Përgjithshëm i “Microsoft Albania”, në vijim e referuar si “Microsoft”), dhe

Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga znj. Milena Harito, ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike (në vijim e referuar si “Qeveria”)

(Në vijim individualisht e referuar si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”).

**1. DEKLARIME**

Meqë Qeveria ka vendosur:

- Të përdorë softuerë të licencuar rregullisht të teknologjisë më të fundit, dhe/ose shërbime, në të gjitha nivelet e administratës publike dhe në arsim, si dhe të rrisë sigurinë dhe transparencën e përdorimit të sistemeve TI dhe të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në administratën publike;

- Të stimulojë industrinë vendëse të TIK-ut dhe të nxisë zhvillimin e njohurive mbi TIK-un të popullatës së Republikës së Shqipërisë (Republika), si dhe aftësimin e tyre në lidhje me të;

- Të garantojë zbatueshmërinë e të drejtave mbi pronësinë intelektuale sipas standardeve të BE-së dhe udhëzimeve të Organizatës Botërore të



Tregtisë (OBT), si dhe zbatimin e plotë dhe efektiv të ligjeve të zbatueshme të Republikës;

- Të rezervojë të drejtën, sipas gjykimit të vet, për të blerë produkte dhe/ose shërbime softuerë nga furnizues të tjerë, që nuk janë pjesë e Microsoft-it.

Meqë Microsoft-i dhe filialet e tij, me qëllimin për të mbështetur përpjekjet e qeverive kombëtare, ka zhvilluar një gamë programesh të zgjeruara që promovojnë TIK-un në administratën publike dhe në institucionet arsimore, po kështu edhe në komunitetin e biznesit dhe dëshiron që këto programe t'i zbatojë në Republikë.

Meqë qeveria i ka bërë të ditur Microsoft-it se për qëllime të arritjes së objektivave të politikës së TIK-ut, do të ishte me interes për Qeverinë të përfitonte nga Microsoft-i dhe filialet e tij një paketë fleksibël me produkte dhe/ose shërbime të kombinuara të “Microsoft Corporation”, e cila do të përdoret nga Qeveria.

## 2. PËRKUFIZIME

Palët bien dakord që termat e përdorur në këtë Marrëveshje të kenë kuptimet e mëposhtme:

2.1 “Republika (e Shqipërisë)” është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe të gjitha zyrat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore që përfaqësojnë interesat e saj.

2.2 “Marrëveshja për kampuset dhe shkollat” është Marrëveshja e Microsoft-it për kampuset dhe shkollat e lidhur midis Microsoft Ireland Operations Limited (MIOL) dhe qeverisë. Marrëveshja për kampuset dhe shkollat është një program pajtimi-licencimi, i krijuar posaçërisht për të trajtuar nevojat specifike të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, si dhe të institucioneve të arsimit të lartë.

2.3 “Partnerë të certifikuar” janë shoqëritë e pavarura, të regjistruara në programin e partnerëve të certifikuar të Microsoft-it. Partnerët e certifikuar u ofrojnë klientëve të tyre teknologji të avancuar të informacionit dhe komunikimit, nëpërmjet konsultimit, shpërndarjes, mirëmbajtjes nga distanca ose në vend, mbështetjes nga qendra e asistencës, aplikacionit të paketës softuerike, shërbimeve të hostimit dhe trajnimit.

2.4 “Marrëveshja e sipërmarrjes” është Marrëveshja e sipërmarrjes e Microsoft-it, e lidhur midis MIOL dhe qeverisë. Marrëveshja e sipërmarrjes zbatohet nga partnerët vendës të MIOL (rishitësit e mëdhenj të Microsoft-it),

nëpërmjet marrëveshjeve të tyre të veçanta me qeverinë.

Marrëveshja e Sipërmarrjes është një marrëveshje licencimi për volume të mëdha softuerësh, e projektuar për klientët korporatë ose publikë me 250 ose më shumë kompjuterë.

2.5 “RMM-të” ose “Rishitësit e mëdhenj të Microsoft-it”, janë rishitësit e autorizuar nga MIOL-ja për të ofruar produkte dhe shërbime të Microsoft-it të përdoruesit fundor në Republikë, në bazë të Marrëveshjes së Sipërmarrjes. Në bazë të këtij autorizimi, qeveria lidh marrëveshje të veçanta me RMM-të për sigurimin e licencave softuerike.

2.6 “Marrëveshja e biznesit dhe shërbimeve e Microsoft-it” është Marrëveshja e biznesit dhe shërbimeve e Microsoft-it, e lidhur midis MIOL dhe qeverisë. Marrëveshja e biznesit dhe shërbimeve e Microsoft, rregullon kushtet kryesore të biznesit dhe ato ligjore që janë të përbashkëta me ato të një Marrëveshjeje sipërmarrjeje dhe një urdhri pune për shërbime sipërmarrjeje.

2.7 “Urdhri i punës për shërbime sipërmarrjeje” përcakton kushtet specifike të projektit për ofrimin e shërbimeve të sipërmarrjes të Microsoft-it: programi strategjik i sipërmarrjes Microsoft, shërbime mbështetjeje dhe konsultimi të nivelit të parë. Programi i strategjisë së sipërmarrjes ofron shërbime këshillimi për klientët, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë potencialin e plotë të investimit të tyre në portofolin e Microsoft-it, si dhe të gjithë ekosistemin e ndikuar prej tij dhe për të ndihmuar në përshpejtimin e zhvillimit të biznesit të klientëve, duke gjetur mënyra të reja dhe më të mira për përdorimin e teknologjisë, për të përfituar avantazhe biznesi dhe për të përfituar maksimalisht nga marrëdhënia e tyre me Microsoft-in.

Mbështetja e nivelit të parë u ofron klientëve asistencë në përdorimin e infrastrukturës së TIK-ut, shërbime nga teknikë profesionistë të përkushtuar, të cilët mbikëqyrin nevojat që kanë klientët për asistencë, duke ofruar asistencë në zgjidhjen e problemeve dhe disponueshmëri ndaj klientit sipas një sistemi 24 orësh dhe 7 ditë në javë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe trajnime dhe seminare që mbajnë të përditësuar stafin e TIK-ut të klientit, mbi teknologjitë më të fundit. Shërbimet e këshillimit të Microsoft-it (MCS) ofrojnë zgjidhje specifike.



### 3. Qëllimi

Palët shprehin interesin e tyre për të vazhduar bashkëpunimin në partneritetin strategjik, në drejtim të zhvillimit e transformimit dixhital të një ekosistemi të qeverisë, të institucioneve publike, të sipërmarrjeve, të shoqërive të sapokrijuara, të universiteteve dhe investitorëve, në të cilat partnerët do të ushtrojnë objektivat e tyre strategjike dhe zgjidhjet novatore me synimin për të nxitur zhvillimin e ekonomisë në Shqipëri, në ambicien dhe vizionin e saj për t'u bërë shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Me synimin për të përfutur në mënyrë të suksesshme nga mundësitë që ofron ekonomia dixhitale, Qeveria ka ndërmarrë një angazhim të madh në drejtim të mbështetjes dhe nxitjes së iniciativave dixhitale, si një instrument i fuqishëm që çon në qeverisje të modernizuar, në ekspertizë më të zhvilluar për një shoqëri që është më e hapur, si dhe në një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë për qytetarët e saj. Ndaj, Qeveria është e vendosur të bashkëpunojë me shoqëritë më të mira, në frymën e një respekti të përbashkët për të bërë të mundur që zgjidhjet dixhitale të sjellin sisteme më të mira dhe më efikase me një qeverisje më të mirë, që do të thotë jetesë më e mirë për të gjithë ne. Microsoft-i synon të kontribuojë me njohuritë e tij dhe rezultatet e kërkimeve e zhvillimeve për krijimin e kushteve të favorshme, që do të mbështesin zgjidhjet në fushën e tij të ekspertizës dhe për rrjedhojë do të kontribuojnë në ekonominë e përgjithshme të vendit.

Në mbështetje të këtij vizioni të përbashkët, Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë MPS në mirëbesim, në mënyrë që të vënë theksin mbi disa koncepte dhe/ose veprime që janë zhvilluar në lidhje me një Bashkëpunim të Mundshëm dhe të përcaktojnë kuadrin për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre koncepteve së bashku.

#### 3.1 Objekti i partneritetit të mundshëm

Është parashikuar që Bashkëpunimi i Mundshëm të mbulojë fushat e mëposhtme por pa u kufizuar te to:

1.1 Qeveria dixhitale (shërbimet ndaj qytetarit, identiteti dixhital, harmonizimi me axhendën dixhitale 2015–2020)

1.2 Strategjia e Sipërmarrjes dhe planifikimi TI - arritja e objektiveve të qeverisë duke maksimizuar vlerën e përfutur nga investimet e qeverisë në teknologji, për t'i hapur rrugën

novacionit - për qytetarët, bizneset dhe nëpunësit civilë.

1.3 Shërbimet e Këshillimit të Microsoft-it mund t'ju ndihmojnë të fitoni:

1.3.1 Arritje të vlerave në një kohë më të shkurtër;

1.3.2 Më pak rrezik dhe më shumë fleksibilitet gjatë zbatimit;

1.3.3 Përshtatje më të mirë - përdorim më të zgjeruar të teknologjisë suaj;

1.3.4 Realizim të përfitimeve më të larta nga investimet tuaja në teknologjitë e Microsoft-it.

1.4 Akses në burime, siç janë ekspertët e lëndës të Microsoft-it, qendrat e ekselencës të Microsoft-it, si dhe rrjeti i partnerëve tanë globalë. Shërbimet proaktive mund t'ju ndihmojnë të minimizoni rrezikun dhe kohën joproduktive, si dhe kostot e asistencës, përmes parandalimit. Asistenca e drejtpërdrejtë me planifikim, nisje, kontrollë shëndetësore rigorozë dhe shërbime rehabilitimi:

1.4.1 Vlerësimi i operacioneve për të ndihmuar proceset e modernizimit, duke përfshirë masat e sigurisë dhe shpërndarjen e burimeve;

1.4.2 Trajnimet praktike dhe transferimi i njohurive për të ndihmuar në zhvillimin e ekspertizës së stafit të TI-së dhe përmirësimin e harmonizimit;

1.4.3 Kohë më e shpejtë përgjigjeje - ju flisni me ekspertin e duhur të lëndës, pikërisht atëherë kur keni nevojë për të.

1.4.4 Akses në rrjetin global të ekspertëve me njohje të thellë të produkteve të Microsoft-it.

1.5 Transformimi dhe produktiviteti i arsimit (avantazhet e studentëve, bashkëpunimi, përdorimi i TIK-ut për qëllime arsimimi për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të fuqizuar rininë.

1.6 Kujdesi shëndetësor (ndërveprueshëria, qendra shëndetësore të lidhura).

1.7 Siguria kibernetike dhe siguria publike.

1.8 Ekonomia dixhitale (evente, shoqëritë e sapokrijuara, nisma inovacioni).

#### 4. Rolet e parashikuara të Palëve

##### 4.1 Microsoft

Microsoft-i ka një përvojë të gjerë, ekspertizë të shkëlqyer dhe aftësi për t'u mundësuar qeverive një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm për rritje ekonomike me shërbimet dhe platformat *mobile first-cloud first*. Microsoft-i është i përkushtuar ndaj zhvillimit dhe ofrimit të zgjidhjeve të sigurta, të besueshme, të përshtatshme dhe të shkallëzuara që



u lejojnë qeverive të ndërveprojnë me qytetarët dhe t'u shërbejnë atyre në mënyrë më efektive, për të marrë njohuri të thella përmes të dhënave dhe dëgjimit social dhe për të krijuar kanale me kosto më të vogël për ofrimin e shërbimit.

Gjatë partneritetit me qeveri të mbarë botës, për më shumë se 25 vjet, Microsoft-i ka mësuar sesi të ndihmojë ekosistemet e ndryshme të avancuara të objektivave qeveritarë, duke qenë të orientuar drejt portofolit në rritje të përgjegjësive të qeverisë - nga transformimi dixhital i qeverisë, politika e taksave, doganat, tregtia dhe transporti të shërbimit komunal, siguria publike, shërbimet shëndetësore dhe njerëzore.

Microsoft-i i konsideron fushat e mëposhtme si me interes të veçantë në këtë bashkëpunim me Qeverinë.

Nga diskutimet e deritanishme parashikohet që roli i Microsoft-it në lidhje me vënien në zbatim të Partneritetit të Mundshëm përfshin sa më poshtë (në varësi të marrëveshjes mes palëve në një fazë të dytë):

4.1.1 Microsoft-i do të mbështesë programin “Qeveria dixhitale” - më shumë shërbime elektronike për qytetarët

Do të ndihmojmë qeverinë të jetë pranë qytetarëve në mënyrë më efektive, në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve elektronike të ofruara nga subjekte të ndryshme.

“Qeveria dixhitale”, ndihma ndaj qeverisë për të operuar në mënyrë më efikase dhe për të përmirësuar produktivitetin e stafit për një shërbim më të mirë ndaj qytetarëve (p.sh., komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët përmes teknologjisë sonë - në pajisjen e zgjedhur nga ju)

Ne synojmë të bëhemi një këshilltar i besuar i organizatave qeveritare, duke ndihmuar në ofrimin e zgjidhjeve teknologjike novatore që përmbushin misionet kritike dhe nevojat e biznesit dhe që kanë një ndikim të konsiderueshëm në jetët e qytetarëve. Drejtimi dhe zgjidhjet tona i ndihmojnë klientët e sektorit publik të bëhen modeli për teknologjinë e sigurt, efikase dhe me fokus misionin.

4.1.2 Siguria kibernetike dhe siguria publike

Një komb-shtet modern varet gjithnjë e më shumë nga hapësira kibernetike për sa i përket ekonomisë së tij, sigurisë publike madje dhe mbrojtjes. Fuqizimi i partneritetit strategjik me Microsoft-in për sigurinë kibernetike është dhe do

të vazhdojë të jetë një element i rëndësishëm i strategjisë së përgjithshme kombëtare dhe ekonomike për një qeveri. Sulme të mëdha kibernetike, humbje të të dhënave dhe rrjete të korruptuara mbushin titujt e gazetave dhe qeveritë, sektori privat dhe qytetarët, të gjithë, pranojnë nevojën për marrjen e masave në drejtim të sigurisë kibernetike.

Microsoft-i mbështet fort qeveritë në marrjen e masave për mbrojtjen e informacionit të tyre më thelbësor dhe të sistemeve të TIK-ut - atyre që nevojiten për të mbështetur sigurinë kombëtare, ekonominë dhe sigurinë publike. Si një shoqëri globale softuerësh, Microsoft-i ka qenë dëshmitare e qindra qasjeve kombëtare për trajtimin e rrezikut kibernetik dhe ka zhvilluar pikëpamjet e veta mbi atë çfarë i duhet një strategji efektive kombëtare për sigurinë kibernetike.

Përgjatë historisë së shoqërisë sonë, Microsoft-i ka punuar me qeveri kombëtare në mbarë botën për t'i ndihmuar ato të krijojnë dhe të shpërndajnë një infrastrukturë dhe shërbime më të sigurta TI që mbrojnë qytetarët e tyre dhe ekonomitë vendëse. Në vitin 2003, Microsoft-i shfrytëzoi këto përpjekje për të krijuar Programin e Sigurisë së Qeverisë - PSQ. Në atë kohë, disa qeveri i kërkuan Microsoft-it të përmirësonte transparencën në mënyrën se si është zhvilluar Windows dhe të jepte prova që produktet tona ishin të lira nga shfrytëzimi i mundshëm qeveritar. Ne, në atë kohë, e krijuam PSQ-në pjesërisht për t'i ndihmuar qeveritë të siguroheshin që ne operojmë me transparencë dhe integritet. Objekti i PSQ-së është zgjeruar me kalimin e kohës dhe sot ai qëndron në qendër të nismave të Microsoft-it në ndihmë të trajtimit të detyrimeve specifike të qeverive në mbarë botën.

PSQ-ja është i mirënjohur si programi hyrës i kodit burimor, por ne inkurajojmë qeverinë ta konsiderojë atë si një nismë strategjike hyrjeje, të projektuar për të ndihmuar në garantimin e një niveli më të thelluar të së drejtës së hyrjes në informacionin dhe burimet e sigurisë, në varësi të kërkesave tuaja. Në një nivel të lartë, PSQ-ja u ofron qeverive kombëtare të drejtën e hyrjes në produkte dhe burime sigurie të rëndësishme të Microsoft-it, duke përfshirë:

- Të drejtën e hyrjes në kodin burimor për produktet kryesore të Microsoft-it;
- Të drejtën e hyrjes në qendrat e transparencës për të punuar drejtpërdrejtë me kodin burimor;



- Informacion i organizuar dhe i analizuar nga Microsoft-i rreth cenueshmërisë nga dhe kërcënimit të sulmeve kibernetike;

- Informacion teknik rreth produkteve dhe shërbimeve të Microsoft-it;

- Mundësia e re “GSP Cloud”.

Ne ofrojmë skenarë të ndryshëm që përfshijnë rishikimin e kodit burim, shkëmbimin e të dhënave teknike dhe informacionin rreth kërcënimeve kibernetike dhe cenueshmërisë, antivirusët (botnet) të ofruara nga programi i Microsoft-it për mbrojtjen nga sulmet kibernetike, mundësi për partneritet me Qendrën e Microsoft-it për Mbrojtjen nga programet keqbërëse (Malware) për ndarjen e telemetrisë dhe për aleancën e informacionit për viruse, si dhe mundësi për partneritet me Microsoft-in për të ndihmuar në mbrojtjen e ekosistemit të gjerë kompjuterik.

4.1.3 Transformimi i arsimit dhe produktiviteti

1.1 Kuadri i transformimit të arsimit. Microsoft-i do të ofrojë një kuadër transformim të projektuar posaçërisht për të ndihmuar qeveritë të ndjekin transformimin e gjithë sistemit, duke përmbledhur kërkimin cilësor të disa dekadave me qëllim që të përmirësohet të mësuarit e vërtetë bazuar në kompetenca, i mbështetur në teknologji, për të angazhuar dhe frymëzuar arsimtarët dhe studentët.

1.2 Licencat në sektorin arsimor. Marrëveshjet e licencimit në sektorin akademik të Microsoft-it hartohen posaçërisht për trajtimin e nevojave dhe kërkesave të sektorit arsimor. Microsoft-i do të vazhdojë të ofrojë për institucionet arsimore që janë përdorues të kualifikuar për arsimin, programin për kampuset dhe shkollat, për të licencuar produkte të përzgjedhura me kushte favorizuese dhe për të rritur në këtë mënyrë nivelin e arsimimit.

1.3 Partnerët në edukim të Microsoft-it. Microsoft-i do të ofrojë programin “Partnerë në edukim” që përfshin zhvillimin profesional të mësuesve, hartimin e kurrikulave dhe promovimin e programeve të Microsoft-it “Arsimtarët novatorë” dhe “Shkollat vitrinë”.

1.3.1 Shkollat model. Microsoft-i do të punojë në drejtim të dhënies së udhëzimeve profesionale në reformën gjithëpërfshirëse në shkolla dhe të një plani për integrimin e teknologjisë për të ndihmuar shkollat të përmbushin objektivat e tyre në arsimim.

1.3.2 Arsimtarë novatorë profesionistë. Microsoft-i do të punojë me qeverinë dhe Ministrinë Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë për të krijuar lidhjen mes një komuniteti global arsimtarësh, duke u fokusuar në të mësuarin në shekullin e 21-të dhe në njohjen e përpjekjeve të tyre të jashtëzakonshme për të përgatitur studentët për të ardhmen.

1.4 Programi “Modelo të ardhmen”. Microsoft-i do t’i ofrojë qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë pjesëmarrjen në nismën që ndihmon qeveritë t’u japin prioritet investimeve në teknologjinë e arsimit. Përmes zhvillimit të këtyre programeve të qëndrueshme, inteligjente dhe përfshirëse, qeveritë mund të realizojnë rritjen ekonomike, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare.

1.5 Programi i Microsoft-it “Imagine Academy”. Ky program ndihmon shkollat e mesme dhe universitetet e anëtarësuar që të kryejnë trajnime për të ndihmuar nxënësit/studentët të përgatiten për karrierën dhe për t’i pajisur ata me certifikata përmes pjesëmarrjes në trajnimin për softuerin dhe teknologjitë më të fundit të Microsoft-it.

1.6 Microsoft-i DreamSpark. Microsoft-i do të ofrojë për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë pjesëmarrjen në programin Microsoft DreamSpark, i cili ofron përdorim falas të mjeteve të programuesit dhe projektuesit të Microsoft-it për studentët e testuar, për të ndihmuar në edukimin dhe aftësimin e tyre nëpërmjet projektimit teknik, teknologjisë, matematikës, shkencave dhe aktiviteteve inxhinierike. Ky program u ofron zhvilluesve të së nesërme, projektuesve dhe profesionistëve të TI-së, mjetet profesionale të nevojshme.

4.1.4 Kujdes shëndetësor dhe shërbime të personalizuar

Microsoft-i i garanton qeverisë se do të ofrojë ekspertizë teknike për të shqyrtuar vendosjen e zgjidhjeve teknologjike në institucionet kryesore të kujdesit shëndetësor, në bazë të tendencave teknologjike globale (si p.sh “Cloud computing”, “Internet of things”, “Big data”, “Wearables” etj.) që pa dyshim tregojnë se si dixhitalizimi i sistemit shëndetësor mund të përmirësojë në mënyrë të qëndrueshme efektivitetin e tij dhe besimin e individëve në sistemin shëndetësor: “Një qytetar i shëndetshëm është një qytetar i kënaqur, që ka



besim në sistemin shëndetësor modern dhe transparent”.

Microsoft-i do të mbështesë çdo synim për zbatimin dhe promovimin e legjislacionit të konsoliduar për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri, sipas legjislacionit të BE-së, dhe për rrjedhojë Microsoft-i do të asistojë qeverinë në përpjekjet e saj për të bërë ndërgjegjësimin e publikut në këtë fushë.

4.1.5 Mbështetja e Microsoft-it për sektorin privat

**BizSpark.** Përmes këtij programi, Microsoft-i ofron softuerë për sipërmarrësit e rinj, me akses në mjetet e zhvillimit të softuerit të Microsoft-it dhe lidhje me aktorët kryesorë të industrisë, për të ndihmuar sipërmarrësit e rinj të fillojnë një biznes të ri.

**Ngritja e kapaciteteve.** Microsoft-i do të vazhdojë të ofrojë mbështetje në zhvillimin e biznesit dhe në ngritjen e kapaciteteve, për t'u dhënë mundësi partnerëve të vet të certifikuar vendës, të arrijnë një nivel cilësie të krahasueshëm me standardet e industrisë, sipas kushteve për të cilat do të bihet dakord me secilin prej partnerëve të certifikuar.

4.2 Qeveria e Shqipërisë

Qeveria do të ndihmojë në rritjen e përdorimit të sistemeve dhe zgjidhjeve novatore të TIK-ut në të gjithë vendin, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, si më poshtë:

- Krijon kuadrin rregullator dhe merr masat e nevojshme për të garantuar që të drejtat e pronësisë intelektuale respektohen dhe mbrohen në të gjitha institucionet shtetërore dhe në sektorin privat, sipas ligjeve dhe rregulloreve vendëse dhe atyre të BE-së. Duke ndjekur modelin: “Udhëhiq duke dhënë shembullin tënd”, Qeveria do të bëjë përpjekjet maksimale për të promovuar përdorimin e softuerëve të duhur të licencuar në sektorin e arsimit dhe në sektorin privat në vend.

- Qeveria do të vendosë sisteme dhe procedura për administrimin e aseteve të softuerëve për të siguruar që brenda qeverisë, si dhe të gjitha institucioneve dhe organizatave të tjera qeveritare të përdoren vetëm softuerë të licencuar rregullisht. Microsoft-i do të ndihmojë qeverinë në përgatitjen e kuadrit dhe të procedurave për administrimin e aseteve të softuerëve.

- Bashkëpunimi me Microsoft-in për të rritur vlerën e shtuar dhe për të forcuar konkurrencë-

shmërinë, duke zbatuar zgjidhje të reja novatore.

- Ngritja e kompetencave për epokën moderne të ekonomisë dixhitale.

- Krijimi i një platforme moderne dhe të qëndrueshme për bashkëpunimi mes palëve të ndryshme të interesuara në fushën e ekonomisë dixhitale të teknologjisë së lartë.

- Ofrimi i vlerave shtesë për qeverinë, bizneset dhe qytetarin shqiptar, me qëllim rritjen e cilësisë së jetës, konkretisht në fushat e shëndetësisë dhe jetesës, arsimit, lëvizshmërisë së qëndrueshme mjedisore, mjedisit të punës etj.

- Njohja e faktit që partneriteti dhe bashkëpunimi i shtetit dhe ekonomisë është me rëndësi të veçantë dhe është konsideruar si mundësi për krijimin e një mjedisi të favorshëm për një shoqëri dixhitale moderne dhe të hapur, që do të lejojë dhe lehtësojë zhvillimin dhe rritjen e zbatimit të zgjidhjeve dixhitale, si për qytetarin ashtu edhe për shumicën e sistemeve shtetërore.

Të gjitha njoftimet drejtuar Qeverisë duhet të dërgohen në Pikën e Kontaktit, më poshtë:

AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Emri i personit të kontaktit: Mirlinda Karcana

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, 1001, Tirana, Albania

Email: mirlinda.karcana@akshi.gov.al

Tel: +355 42 277750

5. Afati

Kjo MPS hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi dhe zgjat tre vjet, pasi të nënshkruhet nga të dyja Palët dhe të miratohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Më pas, ajo zgjidhet automatikisht, nëse asnjë Palë nuk kërkon zgjidhje të parakohshme. MPS-ja mund të zgjidhet nga secila palë për çfarëdolloj arsye ose edhe pa arsye, pasi të dërgohet njoftim me shkrim katër javë para, në fund të një muaji kalendarik.

6. PERSONAT E KONTAKTIT

Palët në këtë memorandum mirëkuptimi caktojnë personat e mëposhtëm si persona kryesorë kontakti në kuadër të kësaj Marrëveshjeje:

Qeveria: Mirlinda Karcana, drejtoreshë e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Microsoft: Sokol Vladi, drejtor i Përgjithshëm, “Microsoft Albania” sh.p.k.



### 6.1 Njoftimet

Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet personave të kontaktit do të kryhen me shkrim, me *email*, me faks, me postë të regjistruar ekspres ose në forma të tjera shkrimi për të siguruar prova të besueshme me shkrim. Njoftimet do të konsiderohen si të dërguara në datën e shënuar në lajmërimin e marrjes në dorëzim ose në konfirmimin e marrjes së faksit ose të postës elektronike.

### 7. Jo e detyrueshme

Palët bien dakord, shprehimisht, që vendosja e partneritetit të mundshëm të parashikuar nga Palët sipas kësaj MPS-je do t'u nënshtrohet marrëveshjeve të veçanta, të cilat do të negociohen e nënshkruhen mes Palëve në një fazë të dytë. Kjo MPS nuk është një marrëveshje e detyrueshme por vetëm një shprehje e synimit aktual të Palëve dhe asnjëra nga Palët nuk ka për qëllim të krijojë ndonjë të drejtë apo detyrim ligjor për palën tjetër, përfshirë këtu edhe ndonjë kërkesë që secila prej tyre duhet të lidhë më vonë një marrëveshje detyruese. Vetëm marrëveshja me shkrim e licencimit, e nënshkruar nga Microsoft Ireland Operations Limited mund të krijojë një marrëveshje licencimi detyruese mes Microsoft-it dhe klientit të tij.

### 8. Mungesa e ekskluzivitetit

Asgjë në këtë MPS nuk krijon marrëdhënie ekskluzive midis Microsoft-it dhe qeverisë në lidhje me objektin e saj. Secila palë do të jetë e lirë të lidhë marrëveshje të tjera të ngjashme ose identike me çdo shoqëri tjetër në lidhje me këtë objekt.

### 9. Kushte të përgjithshme

a) Kjo MPS përbën marrëveshjen e plotë mes palëve në lidhje me objektin e tij dhe i mbizotëron çdo komunikimi të mëparshëm ose të njëkohshëm.

b) Palët do të mbeten gjatë gjithë kohës të pavarura dhe subjekte të veçanta ligjrisht, financiarisht dhe nga ana organizative dhe as nuk mund të veprojnë e as të detyrojnë palën tjetër në ndonjë mënyrë dhe as të deklarojnë se janë përgjegjëse në ndonjë mënyrë për veprimet e palës tjetër.

c) Secila nga Palë, mban përgjegjësi për kostot dhe shpenzimet e veta të shkaktuara si rezultat i lidhjes dhe i realizimit të kësaj MPS-je.

d) Kjo MPS nuk krijon bashkim apo partneritete ndërmjet Palëve dhe as nuk u kërkon Palëve t'i japin ndonjë kontribut financiar njëra-tjetrës, qoftë

për llogari të kësaj MPS-je apo transaksioneve të parashikuara në të.

e) Palët bien dakord shprehimisht se në rast se ndonjë nga Palët nuk është e kënaqur me ecurinë e diskutimeve në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm, atëherë kjo Palë mund të tërhiqet nga diskutimet në çdo kohë dhe sipas gjykimit të saj të vetëm e të pavarur, dhe të tërhiqet nga bashkëpunimi i mundshëm pa asnjë detyrim.

f) Kjo MPS interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

g) Kushtet e përgjithshme të këtij memorandum mirëkuptimi janë konfidenciale, në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm. Asnjë nga palët nuk do të bëjë të ditur këto kushte të përgjithshme apo thelbin e diskutimeve nga të cila kanë lindur ato, për palë të treta të ndryshme nga filialet apo nënkontraktuesit, të cilët: i) kanë nevojë ta marrin këtë informacion, me qëllim që të asistojnë gjatë realizimit të këtij memorandum mirëkuptimi; dhe ii) janë udhëzuar se i gjithë informacioni duhet të trajtohet në konfidencialitet të plotë.

h) Gjuha. Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në 6 kopje, secila në anglisht dhe shqip. Versionet në të dyja gjuhët përmbajnë të njëjtat kushte të përgjithshme. Për qëllime të interpretimit të kësaj marrëveshjeje do të ketë përparësi versioni në anglisht.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje bashkëpunimi strategjik, në datën e shkruar në fillim të saj.

Miratoi dhe pranoi

Për dhe në emër të qeverisë:

\_\_\_\_\_

Emri: Milena Harito

Titulli: Ministre Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike

Data e nënshkrimit: 30.6.2016

Miratoi dhe pranoi

Për dhe në emër të Microsoft-it:

\_\_\_\_\_

Emri: Sokol Vladi

Titulli: Drejtor i Përgjithshëm i "Microsoft Albania"

Data e nënshkrimit: 30.6.2016

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë